

Në bazë nenit 8. të Ligjit të Punës Nr. 03/L-2012 , nenit 8. të Rregullores mbi themelimin e mardhënies së punës në KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU "Hidromorava"-sha Gjilan shpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës në KRU "Hidromorava"-sha Gjilan

-Titulli i pozitës: Zyrtar i Prokurimit

-Nr. i ekzekutuesve: 1 (një)

-Kohëzgjatja e kontratës së punës: Kohë të caktuar me mundësi vazhdimi

-Orari i plotë : 40 orë në javë

-Vendi i Punës : Gjilan

-Paga: Në pajtim me politikën zhvillimore të KRU "Hidromorava"-sha

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bazë të bilansit të materialit nga departamentet e kompanisë si dhe në bazë të gjendjes në depo , përpunon planet mujore dhe vjetore të blerjes;
- Sigurimi i vlerësimit profesional të ofertave në pajtim me procedurat sipas Ligjit të Prokurimit;
- Kryen hulumtimin e tregut të materialit , përcjellë dhe analizon rrjedhat e çmimeve dhe sasive në treg dhe në bazë të saj gjen zgjidhje më adekuate të furnizimit;
- Mbanë evidencën e furnizuesve (sasitë, çmimet, kualitetin dhe dinamikën);
- Përkujdeset për prokurimin sipas planit dhe sipas kualiteteve të përcaktuara;
- Kontakton, pranon dhe kryen biseda afariste me partnerët e vet për prokurim;
- Kryen korrespondencën me partnerët afarist rregullisht dhe me kohë;
- Përpilon dhe i dërgon udhëheqësit financiar raportet mujore dhe vjetore mbi blerjet;
- Mban evidencën dhe përkujdeset mbi likuidimin e obligimeve ndaj furnizuesve;
- Përcjell dhe studion dispozitat ligjore nga lëmia e prokurimit;
- Me kohë dhe afate ligjore kryen procedurat e ofertimit (dosjeve të prokurimit) në harmoni me Ligjin e Prokurimit;
- Nënshkruan kontratat konform dispozitave të Ligjit të Prokurimit;
- Kryen furnizimin me material të kompanisë nga ofertuesit të kontraktuara dhe ato të pa kontraktuara;
- Kryen edhe punë të tjera nga kjo lëmi me urdhër të Kryeshefit Ekzekutiv;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv të kompanisë.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Kualifikimi i lartë superior (Diplomë Universitare) – Fakulteti Ekonomik, Juridik katër /4/ vjeçar ose me sistem të Bolonjës 3+2;
- Përvoja e punës tri /3/ vite ;
- I Çertifikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP-İKAP) ;
- Njohja e punës me kompjuter Word, & Exsel.
- Njohuri të Ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi.

Dokumentet e kërkuara:

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:

- Kopja e diplomës universitare (Ekonomik, Juridik) e noterizuar;
- CV-në ;
- Letër motivimin (jo më shumë se 500 fjalë);
- Dëshmitë për kualifikime tjera profesionale;
- Dëshmia e përvojës së punës;
- Pasqyra e kontributit pensional (nga trusti);
- Çertifikatën se nuk është nën hetime më pak se gjashtë /6/ muaj (nxirret në Gjykatën Themelore në Gjilan) ;
- Certifikatën mjekësore (**Për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese e njëjta do të kërkohet vetëm nga kandidati më i suksesshëm**)

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën për burime njerezore.

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në portalin e gazetës ditore "Zëri", në tabelën e shpalljeve publike të kompanisë dhe ate nga data 14.10.2022 deri më datë 28.10.2022, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes postës elektronike dhe tabelës së shpalljeve publike të Kompanisë.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kryeshefi Ekzekutiv
U.D. Granit Sylejmani



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
“Hidromorava” SH.A
Regional Company for Water
“Hidromorava” J.S.C
Gjilan
